



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**RREGULLORE (QRK) NR. 23/2024 PËR PROCEDURAT DHE KRITERET
E VLERËSIMIT DHE NJOHJES SË STATUSIT DHE TË DREJTAVE TË
PERSONAVE PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË¹**

¹ Rregullore (QRK) – Nr.23/2024 për Procedurat dhe Kriteret e vlerësimit dhe njohjes së statusit dhe të drejtave të personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, është miratuar në mbledhjen e 216 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim Nr.08/216, të datës 14.08.2024

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 17, paragrafit 4 të Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të nenit 8, paragrafit 4, nën paragrafit 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR.23/2024 PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E VLERËSIMIT DHE NJOHJES SË STATUSIT DHE TË DREJTAVE TË PERSONAVE PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vlerësimin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe njohjen e të drejtave të tyre në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë (këtu e tutje: Ligji).

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjitha institucionet dhe trupat që kanë përgjegjësi në zbatimin e procedurave të përcaktuara në këtë Rregullore, si dhe për të gjithë personat që aplikojnë dhe janë përfitues të të drejtave të përcaktuara në Ligj dhe në këtë Rregullore.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, kanë këtë kuptim:

1.1. **Paraplegjikë** - personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme;

1.2. **Tetraplegjikë (kuadriplegjikët)** - personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme;

1.3. **Nevojë sociale** – krijimi i kushteve dhe ofrimi i mundësive për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë për përfshirje në shoqëri dhe për jetesë të pavarur;

1.4. **Parashtrues i kërkesës** - personi që konsideron se ka humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme ose përfaqësuesi i tij ligjor; dhe

1.5. **Përfituesit** – personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë që iu njihet statusi i tillë dhe përfitojnë nga të drejtat e përcaktuara me Ligj.

KAPITULLI II PROCESI I APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT

Neni 4 E drejta e përfitimit

Të drejtën e njohjes së statusit të personit paraplegjik/tetraplegjik dhe e përfitimit nga të drejtat e përcaktuara me Ligj, kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës që plotësojnë kriteret e përcaktuara me Ligj dhe me këtë Rregullore.

Neni 5 Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për njohjen e statusit të personit paraplegjik/tetraplegjik dhe të drejtave të përcaktuara me Ligj, bëhet në formë të shkruar, duke plotësuar dhe nënshkruar formularin e përcaktuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtu e tutje: Ministria), apo në formën elektronike në platformën e përcaktuar nga Ministria.

2. Së bashku me kërkesën, parashtruesi dorëzon dokumentacionin, si në vijim:

2.1. Kopjen e dokumentit të identifikimit valid të Republikës së Kosovës; dhe

2.2. Dokumentacionin përkatës mjekësor lidhur me gjendjen shëndetësore.

3. Kërkesa e paraqitur në formë fizike dorëzohet në Zyrën Pensionale në vendbanimin e aplikuesit, ku aplikuesi pajiset me fletë dëshmi për aplikacionin e dorëzuar.

4. Kërkesa e paraqitur në formë fizike i përcillet Divizionit të Komisioneve Mjekësore, për t'iu paraqitur Komisionit Vlerësues.

Neni 6

Vlerësimi paraprak i kërkesës

1. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e kërkesës, Komisioni Vlerësues bën vlerësimin paraprak të kërkesës.
2. Nëse Komisioni Vlerësues konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga parashtruesi i kërkesës është i plotë dhe i mjaftueshëm për vlerësimin e kërkesës, brenda tridhjetë (30) ditëve bën vlerësimin e kërkesës në seancën vlerësuese.
3. Nëse Komisioni Vlerësues konstaton se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm për vlerësim, kërkon nga aplikuesi plotësimin e dokumentacionit dhe e bën vlerësimin pas plotësimit të dokumentacionit.

Neni 7

Vlerësimi i kërkesës

1. Vlerësimi i parashtruesit të kërkesës zhvillohet në hapësirat e Ministrisë, nëpër degët lokale të saj apo në hapësirat e tjera të përshtatshme, me prezencën fizike të parashtruesit të kërkesës. Përrjashtimisht, për raste të caktuara kur Komisioni Vlerësues konstaton se dokumentacioni i paraqitur është i mjaftueshëm për të bërë vlerësimin, mund të bëjë vlerësimin pa pjesëmarrjen fizike të parashtruesit të kërkesës.
2. Parashtruesi i kërkesës i cili për shkaqe shëndetësore apo shkaqe të tjera e ka të pamundur pjesëmarrjen fizike në seancën vlerësuese, atëherë vlerësohet nëpërmjet vizitës në shtëpi nga Komisioni Vlerësues apo nëpërmjet formave tjera të përshtatshme.
3. Bazuar në vlerësimin e dokumentacionit të parashtruar nga aplikanti dhe ekzaminimet që bën Komisioni Vlerësues të parashtruesi i kërkesës, në procesin e vlerësimit Komisioni Vlerësues bën vlerësime si në vijim:
 - 3.1. Vlerësimin nëse parashtruesit të kërkesës i njihet statusi i personit paraplegjik/tetraplegjik;
 - 3.2. Vlerësimin nëse përfituesi ka drejtë për kujdestar personal;
 - 3.3. Vlerësimin nëse përfituesi fiton kompensim shtesë për parandalimin e plagëve dekubitare; dhe
 - 3.4. Vlerësimin e nevojave sociale të përfituesit.

Neni 8

Vlerësimi për njohjen e statusit paraplegjik / tetraplegjik

1. Bazuar në dokumentacionin mjekësor të prezantuar nga parashtruesi i kërkesës, si dhe në verifikimet dhe ekzaminimet që i zhvillon Komisioni Vlerësues, parashtruesit të kërkesës mund t'i njihet statusi i personit paraplegjik/tetraplegjik.
2. Njohja e statusit të personit paraplegjik/tetraplegjik të paraqitësit të kërkesës, ka karakter të përhershëm dhe nuk i nënshtrohet procesit të rregullt të rivlerësimit.

Neni 9

Vlerësimi për njohjen e drejtës për kujdestar personal

1. Përfituesve që i njihet statusi i personit paraplegjik/tetraplegjik, mund t'i njihet e drejta për kujdestar personal.
2. Njohja e të drejtës për kujdestar personal për personin paraplegjik/tetraplegjik, përcaktohet bazuar në gjendjen shëndetësore të tij. Pra, bazuar në dokumentacionin mjekësor të prezantuar nga përfituesi, në verifikimet dhe ekzaminimet që i zhvillon Komisioni Vlerësues, si dhe në rrethanat sociale të tij, domethënë në nivelin e lëvizshmërisë të përfituesit, rrethanat familjare dhe rrethanat e tjera që përcaktojnë nevojën për ofrimin e kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore.
3. Përfituesit të cilët kanë pasoja të përhershme në gjendjen shëndetësore (lëndim spinal, humbje të përhershme të ndjeshmërisë, inkontinencë dhe të ngjashme), i njihet e drejta për kujdestar personal. Njohja e kësaj të drejte ka karakter të përhershëm dhe nuk i nënshtrohet rivlerësimit të rregullt.
4. Përfituesit të cilët nuk kanë pasoja të përhershme në gjendjen shëndetësore, por kanë rrethana sociale që pamundësojnë jetesë të pavarur, mund t'iu njihet e drejta për kujdestar personal. Varësisht nga gjykimi i Komisionit Vlerësues, njohja e kësaj të drejte mund të ketë karakter të përhershëm që nuk i nënshtrohet rivlerësimit të rregullt apo mund të ketë karakter të përkohshëm dhe i nënshtrohet procesit të rregullt të rivlerësimit pas tri (3) viteve të përfitimit.
5. Në rast të refuzimit të të drejtës për kujdestar personal, përfituesi mund të kërkojë rivlerësim në çdo kohë pas gjashtë (6) muajsh nga dita vendimit, në rast të ndryshimit të rrethanave të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.
6. Parashtruesit të kërkesës që nuk i njihet statusi i personi paraplegjik/tetraplegjik, nuk i nënshtrohet vlerësimit për njohjen e drejtës për kujdestar personal.

Neni 10

Vlerësimi për njohjen e të drejtës për kompensim shtesë për parandalimin e plagëve dekubitare

1. Përfituesit që i njihet statusi i personit paraplegjik/tetraplegjik, mund t'i njihet e drejta për kompensim shtesë për parandalimin e plagëve dekubitare, të cilët plotësojnë kushtet si në vijim:
 - 1.1. Ka pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë;
 - 1.2. Përdor medikamente në baza ditore (në baza të rregullta); dhe
 - 1.3. Ka humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve të poshtme apo të larta.
2. Njohja e të drejtës për kompensim shtesë për parandalimin e plagëve dekubitare për gjendjen shëndetësore për personat paraplegjikë/tetraplegjikë, varësisht nga gjykimi i Komisionit Vlerësues, mund të ketë karakter të përhershëm që nuk i nënshtrohet rivlerësimit të rregullt, apo mund të ketë karakter të përkohshëm dhe i nënshtrohet procesit të rregullt të rivlerësimit pas tri (3) viteve të përfitimit.
3. Në rast të refuzimit të njohjes të së drejtës për kompensim shtesë për parandalimin e plagëve dekubitare për personat paraplegjikë/tetraplegjikë, përfituesi mund të kërkojë rivlerësim në çdo kohë pas tre (3) muajsh nga data e vendimit, në rast të ndryshimit të rrethanave të parapara në paragrafin 3 të këtij neni.
4. Parashtruesit të kërkesës që nuk i njihet statusi i personit paraplegjik apo tetraplegjik, nuk i nënshtrohet vlerësimit për njohjen e të drejtës për kompensim shtesë për parandalimin e plagëve dekubitare dhe të të drejtës për kujdestar personal.

Neni 11

Vlerësimi për përcaktimin e nevojës sociale

1. Përfituesit që i njihet statusi i personit tetraplegjik/paraplegjik, i bëhet edhe vlerësimi i nevojave sociale, përfshirë këtu vlerësimin e nevojës për edukim dhe arsim, për punësim dhe për rehabilitim.
2. Komisioni Vlerësues bën konstatime dhe jep rekomandime, lidhur me adresimin e nevojave sociale të përfituesit.
3. Parashtruesit të kërkesës që nuk i njihet statusi i personi paraplegjik apo tetraplegjik, nuk i nënshtrohet vlerësimit për përcaktimin e nevojës sociale.

Neni 12

Raporti i vlerësimit dhe vendimi

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të secilës kërkesë sipas dispozitave të Ligjit dhe kësaj Rregulloreje, Komisioni Vlerësues harton raportin e detajuar të vlerësimit me konstatime lidhur me njohjen e statusit të personit paraplegjik apo tetraplegjik, dhe me konstatime lidhur me njohjen e të drejtave të tjera.
2. Raporti nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues dhe një kopje i dërgohet parashtruesit të kërkesës.
3. Bazuar në raportin e Komisionit Vlerësues për kërkesën, hartohet vendimi lidhur me njohjen apo jo të statusit të personit paraplegjik apo tetraplegjik, si dhe lidhur me njohjen e të drejtave tjera të përcaktuara në Ligj dhe në këtë Rregullore.
4. Vendimi nënshkruhet nga Kryesuesi i Komisionit Vlerësues dhe një kopje i dërgohet parashtruesit të kërkesës.

Neni 13

Procedura ankimore

1. Parashtruesi i kërkesës që është i pakënaqur me vendimin e Komisionit Vlerësues, mund të ushtrojë ankesë brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit.
2. Ankesa mund të paraqitet në formë fizike apo në mënyrë elektronike në platformën e përcaktuar nga Ministria.
3. Ankesa e paraqitur në formë fizike dorëzohen në Zyrën Pensionale në vendbanimin e aplikuesit, ku aplikuesi pajiset me fletë dëshmi për aplikacionin e dorëzuar.
4. Ankesat përcillen pranë Divizionit për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave dhe shqyrtohen nga ky Divizion apo nga një komision i veçantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
5. Pala e pakënaqur me vendimin e shkallës së dytë, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore, në Departamentin për Çështje Administrative, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 14

Vendosja në pagesë

1. Përfituesit, sipas vendimit të Komisionit Vlerësues, vendosen në pagesë nga Ministria, varësisht nga të drejtat që përfitojnë.

2. Të gjitha pagesat i paguhen drejtpërdrejtë përfituesit që ka zotësi juridike, apo kujdestarit të përfituesit i cili nuk ka zotësi juridike.

3. Pagesa për kujdestarin personal mund të bëhet te kujdestari, në rast se përfituesi parashton një kërkesë të tillë.

Neni 15

Mbajtja dhe përpunimi i dosjeve të përfituesve

1. Ministria mban dhe përditëson dosjet e përfituesve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Ministria mund të kërkojë dokumentacion shtesë nga përfituesit, me qëllim të përditësimit të informatave të përfituesve dhe mundësimin të përfitimit të të drejtave të tjera, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Rivlerësimi pas monitorimit dhe kontrollit (Rivlerësim i jashtëzakonshëm)

1. Komisioni Vlerësues bën rivlerësimin e përfituesve, nëse pas monitorimit dhe kontrollit të zhvilluar nga Divizioni për Kontrollin e Skemave Pensionale dhe Sociale në kuadër të Ministrisë, është konstatuar se vlerësimi i kërkesës së kontrolluar nuk është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, apo vlerësimi fillestar nuk është në përputhje me gjendjen e konstatuar të personit pas rivlerësimit.

2. Rivlerësimi zhvillohet sipas procedurave dhe kriterëve të njëjta të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI III

PËRBËRJA DHE FUNKSIONET E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 17

Përbërja e Komisionit Vlerësues

1. Me qëllim të vlerësimit të kërkesave për njohjen e statusit të personit paraplegjik/tetraplegjik dhe njohjes së të drejtave të tjera, të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Rregullore, Ministria themelon Komisionin Vlerësues në përbërje si në vijim:

1.1. Një përfaqësues i Ministrisë – Kryesues/e;

1.2. Një neurolog – anëtar/e;

- 1.3. Një urolog – anëtar/e;
 - 1.4. Një fiziatër – anëtar/e; dhe
 - 1.5. Një ekspert i licencuar i fushës së punëve sociale – anëtar/e
2. Në punimet e Komisionit merr pjesë edhe një përfaqësues nga shoqatat e licencuara që ofrojnë shërbime për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në cilësinë e vëzhguesit.

Neni 18

Mënyra e përzgjedhjes së Komisionit dhe kompensimi

1. Kryesuesi i Komisionit Vlerësues emërohet nga stafi i shërbimit civil të Ministrisë apo ndonjë përfaqësues i jashtëm. Kryesuesi duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune në sektorin publik dhe njohuri të mirë të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të legjislacionit në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
2. Anëtarët e Komisionit kontrahohen për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit në Komisionin Vlerësues, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe duhet të kenë së paku pesë (5) vite përvojë pune në profesionin e tyre.
3. Përbërësit nga paragrafi 2 i këtij neni, në rast të mungesës së ndonjë anëtari të Komisionit Vlerësues dhe pamundësisë së zëvendësimit të shpejtë, Ministria mund të angazhojë përkohësisht staf përkatës nga institucionet shëndetësore.
4. Përfaqësuesi i shoqatave të licencuara që ofrojnë shërbime për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, i cili merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në Komisionin Vlerësues, emërohet pas procesit të hapur të shpalljes së bërë nga Ministria.
5. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit kompensohen për punën e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përfaqësuesi i shoqatave të licencuara nuk kompensohet për punën e bërë, por merr mëditje ditore për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera ditore.

Neni 19

Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues

1. Komisioni Vlerësues ka këto funksione dhe përgjegjësi:
 - 1.1. Vlerëson dokumentacionin e parashtruesit të kërkesës dhe në rast nevojë, ekzaminon parashtruesin e kërkesës;
 - 1.2. Vlerëson dhe përcakton statusin e personit paraplegjik/tetraplegjik, si dhe vlerëson dhe përcakton të drejtat e tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Rregullore.

Neni 20
Roli i Divizionit për Shërbimet Mjekësore

Divizioni i Komisioneve Mjekësore në kuadër të Ministrisë, ofron shërbime administrative dhe teknike për Komisionin Vlerësues.

KAPITULLI IV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21
Njohja e vlerësimit paraprak

1. Të gjithë përfituesit që janë vlerësuar paraprakisht sipas dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, dhe janë kategorizuar si përfitues të grupit të parë, i njihet statusi i personit paraplegjik/tetraplegjik dhe të drejtat e tjera të përcaktuara sipas dispozitave të neneve 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje.
2. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashetrojnë kërkesë për vlerësimin e nevojave sociale, brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Neni 22
Kërkesa për rivlerësim të vlerësimit paraprak

1. Të gjithë përfituesit që janë vlerësuar paraprakisht sipas dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, dhe janë kategorizuar si përfitues të grupit të dytë, brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje mund të kërkojnë rivlerësim sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
2. Rivlerësimi sipas këtij neni, zhvillohet sipas dispozitave të Kapitullit II të kësaj Rregulloreje.
3. Personat që nuk bëjnë kërkesë për rivlerësim sipas këtij neni, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1, i njihet automatikisht statusi i personit paraplegjik/tetraplegjik pa të drejta të tjera të përcaktuara sipas dispozitave të neneve 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 23
Dispozita e shfuqizimit

Me miratimin e kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (QRK) Nr.07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 shtator 2024 dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

25 gusht 2024